REPUBLIKA E KOSOVES
GJYKATA THEMELORE NË GJILAN

Regj.nr.16630/ 2012

DEPARTAMENTI I PERGJITHSHEM-DIVIZIONI PËR KUNDËRVAJTJE, sipas gjyqtarit Ramush Ademi, dhe sekr,Juridik Nuhi Ismaili duke vendosur në lendën për kundërvajtje ndaj të pandehurit Arben Maliqi nga fsh,Kosaqë,për shkak të veprës kundërvajtës – mosdeklarim i rregullt vjetor i pasurisë të parashikuar nga neni 9 paragrafi 1.dhe i ndëshkuar sipas nenit 17 paragrafi 1 pika 1.5 sippas kerkeses së Agjensise Antikorrupsion të Ligjit për Deklarimin,Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë të zyrtarve të lartë publik dhe deklarimin ,prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave per të gjith personat zyrtar Nr. 04/L-050 të dt.31.08.2011.Gz.nr .16 data 14.10.2011 e në bazë të nenit 73, 74,195,199 dhe 9 të Ligjit mbi Kundërvajtjet, më dt. 27 nëntor 2013, mori këtë:

## A K T V E N D I M

I Pandehuri Arben Maliqi nga babai Fehmi i lindur më 30.10.1967 në fsh,Kosaqë,tani me vend banim në Gjilan Lagja Dardania I rr,"Beqir Musliu"rr.2/70 ku edhe jeton shqiptar shtetas i Republikës së Kosovës ,Profesor ,i martuar babë i tre fëmijeve,kinse nuk është i dënuar e as nën hetime madhor.

## Ë SH T Ë  P Ë R GJ E GJ Ë S

Sepse i pandehuri ne afatin e parapar sipas ligjit të lartcekur dhe kerkesese së agjensionit Antikorrupsion nuk është shkuar në selin e Agjensionit,kur është ftuar për sqarim dhe plotësim të formularin për deklarimin e pasurisë dhe dhuratave të cilin e ka dorzuar sipas numrit portkolit.nr,03-3083/12 te datës 30.03.2012 per ti sqaruar dhe plotësuar lidhur me të dhënat pasurore të paraqitura.
Me kete veprim ka ber veprën kundervajtese ,nga neni 9 ,paragrafi 1 ,ndeshkuar sipas nenit 17 parg,1 dhe 1.5 te ligjit per deklarimin ,prejadhrejn dhe kontrollin e pasuris te zyrtarve te lart publik dhe deklarimin ,prejardhejn dhe kontrollin e dhuratave per te gjithe personat zyrtar,e per ate shpallet pergjegjes dhe,

## D E N O H E T

Me dënim gjobe ne shum prej 300 (treqind)Euro.
Obligohet i pandehuri që dënimin e shqiptuar me gjobe ta paguaj ne afat prej 15 ditesh nga dita e plotfuqiahmeris se këtij Aktvendimi, në të kundërtën dënimi me gjobe ka ti zëvendësohet ne dënim burgu ne kohe zgjatje prej 15 dite,duke llogaritur per nje dit burgu te filluar 20 njezet Euro.
Obligohet i pandehuri qe ne emër te paushallit Gjyqesor toi paguaj kësaj gjykate shumen prej 10 dhjet Euro ,në afatin e njejte si dënimin me gjobe.
Me nga nje kopje të këtij aktvendimi të njoftohen palët në procedurë.

## A r s y e t i m

Agjencia Kundër Korrupsionit nga Prishtina i ka paraqitur kësaj gjykate kërkesë nr. 01-3947/12 të dt. 01.11.2012 për fillimin e procedures për kundërvajtje ndaj të paraqiturit Arben Maliqi nga Gjilani, për shkak të veprës kundërvajtëse- mosdeklarim i pasuris sipas kerkeses se Agjensionit nga neni 9 paragrafi 1 dhe i ndëshkuar sipas nenit 17 paragrafi 1 pika 1.5 të Ligjit për Deklarimin , Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Dhuratave të Zyrtarve të Lartë publik Nr. 04/L-050 të dt. 31.08 2011, dhe ka kërkurar që i njejti të shpallet përgjegjës dhe të dënohet sipas ligjit.
Gjykatesi shqyrtoi kërkesen dhe konstatoi se e njeta është e bazuar nëe ligj.
Gjykatësi ndërmuar procedure, ka marr në pytje të pandehurin Arben Maliqi i cili në mbrojtjen e vet të dhën te gjyqtari për Kundervajtje ka deklaru se vërtet Agjensioni Antikorrupsion nga

REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KORRUPSIONIT
KORUPCIJE
ANTICORRUPTION AGENCY
DPK/DMP
Nr. Prot. / Br.Prot. / Prot No. 03-4180/13
02
Data / Datum / Date 06.12.2013
PRISHTINE

03-4180/13/02

Prishtina me ka ftuar që personalisht të shkoj në selin e Agjensionit në Prishtinë lidhur me deklarimin dhe plotsimin e formularit mbi deklarimin ,prejardhjen e pasurisë të cilin e kam dorzuar në afatin ligjor me 30.03.2012,është e vertet ka deklaru i pandehuri se Agjensioni i lartpermendur me ka ftuar për mes telefonit tek një zyrtari i kuvendit lomunal ,i cili më ka informuar pasi jam kthyer nga seminari që kam qen në Poreq të R.së Kroacisë por i njejti me tutje ka cekur se në atë koh kur është ftuar nga Agjensioni nuk ka qen në shtëpi ka deklaru kinse ka qen në R.e Kroacisë në nje seminar e po ashtu ka deklaru se pas seminarit ka shkuar me shkollen ku punon si Arsimtar në ekskurzion në R.e Shqipërisë andaj për këto arsye nuk ka mundur të lajmrohet në selin e Agjensionit Antikorrupsion në Prishtinë.I pandehuri me tutje ka deklaru dhe ka marr për obligim gjykates ti sjelli pasaporten për të dëshmu se në atë kohë ka qen jasht vendit poashtu ka cekur se pasi është kthyer nga seminari prej Kroacise dhe ekskurzioni prej Shqiperis doti sjelli deshmit për mes pasaportes kallimin e kufirit te Kosoves ,por gjer më diten e marrjes së këtij Aktvendimi nuk e ka bër një gjë të këtillë gjykates nuk i ka sjellur një deshmi të tillë.

Gjykatesi nga mbrojtja e te pandehurit ka nxjerrur faktin e mjaftushem pasi i njejti në një far mënyre e ka pohuar vepren kundervajtese nuk është pergjegjur në kerkesen e Agjensionit Anti korrupsion kur është ftuar andaj gjykata muar këtë aktvendim ,duke e shpallur pergjegjes për kundervajtjen e cila i vihet në barr sipas kërkkesës ,duke u bazuar në shkresat e lëndes ,në mbrojtjen e te pandehurit ,pohimin e vepres nga ana e tije ,sepse nuk eshte lajmruar me ftesen e Agjensionit ,andaj duke u bazuar në nenin 9 parag.1 dhe dispozites ndëshkimore të nenit 17.p.1 dhe nenit 1.5 të ligjit për deklarimin,prejardhjen dhe kontrollin e pasuris dhe dhuratave të zyrtarve të lart publik,e ndeshkoi me denim gjobe njejt si dispozitiv te ketij aktvendimi.

Me rastin e matjes dhe shqiptimit te denimit gjykatesi pati parasysh posaqerisht si rrethan lehtesuse se i pandehuri e ka lajmruar pasurin në afatin ligjor me 30.03.2012.por kur eshte ftuar nga Agjensioni qe te shkoj ne selin e tyre per disa sqarime i njejti nuk i eshte pergjegjur fteses ,andaj gjjykata i zbuti denimin nen minimumin e parapar dhe i shqiptoi kete denim me gjobe ,duke u bazuar ne nenin 9 te ligjit mbi kundervajtjet ,i bindur se edhe me kete denim ka per tu arritur qellimi i denimit tek i pandehurit qe ne te ardhmen te mos perseris kundervajtje te ketille apo te ngjashme.

Nga të cekurat e mësipërme u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE-DIVIZIONI PËR KUNDËRVAJTJE NË GJILAN

Më dt. 27.11. 2013

Sek,Juridik.
Nuhi Ismaili

Gjyqtari:
Ramush Ademi

Këshilla Juridike:Kundër këtij aktvendimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 8 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktvendimi, Gjykatës se Apelit në Prishtinë-Divizionit Kundervajtes. Ankesa dorzohet përmes kësaj Gjykate.